



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 638/ prot.

Tiranë më 10.5.2019

Lënda: Mendim mbi një Protokoll Ndryshues

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr. 3397 prot., datë 19.04.2019, mbi "*Protokollin Ndryshues të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Sekretarit të Shtetit për Departamentin e Punëve të Brendshme që operon nëpërmjet Agjencisë së Kufirit të Mbretërisë së Bashkuar për shkëmbimin e informacionit për qëllime që lidhen me migracionin*", Zyra e Komisionerit vlerëson se i gjithë procesi për shkëmbimin e informacionit për qëllime që lidhen me migracionin, duhet të kryhet në respektim të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale të parashikuara në aktet ndërkombëtare si dhe ato të sanksionuara në legjislacionin vendas.

Sa i përket riformulimit të termit "*Të dhëna personale*" në tekstin e Memorandumit, ndryshimi është kryer sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, por sugjerojmë që ky përkufizim duhet të jetë më afër standardeve të Rregullores së re për mbrojtjen e të dhënave personale (GDPR), e cila ka të njëjtin përkufizim me Direktivën 2016/680 të Parlamentit dhe Këshillit të Europës.

Sa më sipër sugjerojmë riformulimin në: "*Të dhëna personale* është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm ('subjekt i të dhënave'); një person fizik i identifikueshëm është ai i cili mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi si një emër, një numër identifikimi, të dhëna për vendndodhjen, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e të dhënave personale të shkëmbyera gjatë procesit të transferimit të informacionit, sugjerojmë që paragrafi 8.1 të mos hiqet nga Memorandumi i Mirëkuptimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

